

INTEGRIMI EVROPIAN



Ministri Hasani mirëpriti në aeroportin ndërkombëtar “Nënë Tereza”, Sekretarin e Shtetit të Mbretërisë së Bashkuar për Çështjet e Jashtme, Komonuelthin dhe Zhvillimin, Lord David Cameron, i cili zhvilloi një vizitë disa orëshe në Tiranë. Ministri Hasani çmoi mbështetjen e MB në rrugën e Shqipërisë drejt integritimit në BE, dhe nënvizoi se Shqipëria mirëpret investimet dhe mbështetjen britanike në sektorët strategjikë, si mbrojtja, siguria, energjia infrastruktura etj.



Në panelin e diskutimit të organizuar nga MEPJ në Ditën e Evropës, e ku morën pjesë përfaqësues të trupit diplomatik të akredituar në Tiranë, Ministri Hasani theksoi se përshpejtimi i integritimit në BE, e bën familjen evropiane më të plotë e të sigurt.



MEPJ Igli Hasani priti në një takim të Dërguarin e Posaçëm të Francës për Ballkanin Perëndimor, Rene Trocçaz. Ministri Hasani shprehu mirënjohjen për kontributin e çmuar të Francës në procesin e anëtarësimit të Shqipërisë dhe Ballkanit Perëndimor në BE përfshirë ekspertizën dhe burimet e përkushtuara në forcimin e institucioneve dhe përafrimin e politikave me standardet e BE- së.



Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Igli Hasani, zhvilloi një takim me Ministrin e Shtetit për Çështjet Evropiane dhe Ndërkombëtare të Bavarisë, Eric Beißwenger. Ministri Hasani vlerësoi angazhimin e palëkundur të Republikës Federale Gjermane dhe mbështetjen e autoriteteve bavareze në rrugën e integritimit të Shqipërisë në BE.



Në përfundim të sesionit të 133-të të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, Ministri Hasani u shpreh se pala shqiptare do vijojë përpjekjet e saj deri në anëtarësimin e plotë të Kosovës në KIE.



MEPJ Igli Hasani, zhvilloi një bashkëbisedim me nxënës të shkollave të mesme, në kuadër të 75 vjetorit të Këshillit të Evropës. Në fjalën e tij përshëndetëse, ministri Hasani theksoi rëndësinë e edukimit për qytetarinë demokratike, teksa e cilësoi atë si themelin e një shoqërie të drejtë dhe të barabartë.



Më datë 16 maj 2024, në ambientet e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, u mbajt një takim mes përfaqësuesve të MEPJ dhe Konsujve të BE të akredituar në Tiranë. Në fokus të takimit ishin çështje të ndryshme me interes të përbashkët, si rritja e bashkëpunimit me institucionet e RSH-së, rritja e turizmit në Shqipëri, planveprimi i trajtimit të rasteve të emergjencave etj.

RAJONI



I pranishëm në takimin e PABSEC, Ministri Hasani u shpreh se dimensionin parlamentar i BSEC duhet të luajë një rol të dorës së parë në bashkëpunimin jo vetëm mes parlamenteve, por edhe të shoqërive të vendeve anëtare.

SIGURIA



Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Igli Hasani, zhvilloi një takim me Ministrin e Shtetit Kundër Migrimit të Paligjshëm të Mbretërisë së Bashkuar, Michael Tomlinson. Ministri Hasani rikonfirmoi vullnetin e palës shqiptare për të forcuar bashkëpunimin në çështjet e sigurisë dhe punëve të brendshme, rritjen ekonomike dhe investimet, etj.



MEPJ Igli Hasani mori pjesë në konferencën ndërkombëtare “Lennart Meri” që u mbajt në kryeqytetin e Estonisë, ku theksoi se, agresioni rus në Ukrainë vijon të mbetet kërcënimi më kritik për paqen dhe sigurinë në kontinentin evropian dhe më gjerë.